

LIGJ
Nr. 48/2023

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 22/2018,
“PËR STREHIMIN SOCIAL”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe shpërndarjes së programeve sociale për strehim, si dhe programit për strehim të të punësuarve të administratës publike, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm e të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1 me këtë përmbajtje:

“11/1. “Njësia e vetëqeverisjes vendore” është bashkia, çdo ent publik, person juridik apo ndërmarrje në varësi/pronësi të saj”.

2. Pas pikës 15 shtohet pika 15/1 me këtë përmbajtje:

“15/1. “Familje e re” në kuptim të këtij ligji është familja e krijuar si rezultat i martesës së lidhur përpara nëpunësit të gjendjes civile ose bashkëjetesës së deklaruar para noterit publik, sipas Kodit të Familjes, kur moshja e anëtarit më të madh të të cilës në momentin e paraqitjes së kërkesës është më e vogël ose baras me 40 vjeç.”.

3. Pika 16 ndryshon si më poshtë:

“16. Fondi publik i banesave sociale” është tërësia e banesave sociale në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, i cili përdoret në funksion të programeve sociale të strehimit dhe që krijohet nëpërmjet blerjeve në treg të lirë, investimeve për ndërtime të reja përfshirë këtu financimin për këto investime të konvertuara në vlerë monetare me vlerat e tregut të zonës ku ndërtohet, të paguara në lek nga subjekti privat si kontribut i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, banesat e marra në dorëzim nga sektori privat si detyrim i kalimit të sipërfaqes funksionale ndërtimore për krijimin e këtij fondi, kalimit të pronësisë nga partneritete publike private ose nëpërmjet përfitimit nga mënyrat e tjera që vijnë nga ndërtimet private, si dhe nga burime të tjera, të parashikuara në këtë ligj.”

4. Pika 25 ndryshohet si më poshtë:

“25. “Kushte emergjente për strehim” janë kushtet në të cilat ndodhen individët/familjet që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare, në banesa në proces legalizimi që pësojnë dëme për shkak të fatkeqësive natyrore, në banesa që prishen për shkak të

ndërtimeve të veprave publike, të cilët nuk përfitojnë kompensim financiar nga procedurat e shpronësimit, dhe të ndërtimeve në proces legalizimi që nuk legalizohen, por trajtohen nga shteti nëpërmjet programeve të strehimit të përshtatshme, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë dhe ato familje/individë, të cilët ndodhen në kushtet e situatës së dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje lëshuar nga gjykata.”.

5. Pas pikës 28 shtohet pika 28/1 me këtë përmbajtje:

“28/1. “Përmirësim i kushteve të zonave të papërshtatshme” do të thotë tërësia e punimeve që duhet të kryhen me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në shkronjat “ç” e “d” të nenit 4 të këtij ligji, sipas kushteve dhe kriterëve që përcaktohen në thirrjet që shpallen nga ministria përgjegjëse për strehimin në zbatim të buxhetit vjetor.”.

6. Pika 44 ndryshohet si më poshtë:

“44. “Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen të ardhurat nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara dhe pagesat që marrin pjesëtarët e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror; përfitimet e personave me aftësi të kufizuara sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës; përfitimet nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuar, e parashikuar në legjislacionin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, legjislacioni për statusin e të verbrit dhe legjislacioni për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik; përfitimet nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike, nga rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.”.

7. Pas pikës 51 shtohen pikat 52, 53, 54, 55, 56, 57 dhe 58 me këtë përmbajtje:

“52. “Zona të papërshtatshme banimi” janë zona të banuara, ku banorëve u mungojnë një apo disa kushte të përshtatshme të banimit, sipas përcaktimeve në nenin 4 të këtij ligji.

53. “Monitorim” është mbikëqyrja e realizimeve të investimeve për programet sociale të strehimit me financime nga buxheti i shtetit ose me bashkëfinancime nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe/ose donatorët.

54. “I punësuar në administratën publike” është nëpunësi civil dhe çdo punonjës administrativ i punësuar në një institucion të administratës publike, i cili ka marrëdhënie punësimi, sipas legjislacionit të posaçëm që rregullon këtë marrëdhënie, me afat të pacaktuar.

55. “Institucione të administratës publike” janë institucionet e administratës shtetërore, Forcat e Armatosura, institucionet e pavarura dhe njësitë e fondeve speciale.

56. “Institucion i administratës shtetërore” janë Kryeministria, ministritë, institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome dhe administrata e prefektit.

57. “Institucion i pavarur” është institucioni i pavarur i parashikuar si i tillë në Kushtetutë ose i krijuar me ligj dhe që i raporton Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale.

58. “Njësi e fondeve speciale” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 3

Në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 11 fjalët “deri në ndërtim të ri” zëvendësohen me fjalët “dhe zonave të papërshtatshme”.

Neni 4

Në nenin 14 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës *on-line* në portalin unik qeveritar “e-Albania”. Të dhënat që gjenerohen nga kërkesat janë pjesë e bazës së të

dhënave, të krijuar sipas shkronjës “d”, nënndarjet “i” dhe “iv” të nenit 72 dhe shkronjës “e” të nenit 73 të këtij ligji. Procedura e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Individit ose përfaqësuesi/ja i/e familjes, që vetëdeklarohet me paaftësi apo pamundësi aksesi në rrjetin e komunikimeve elektronike, u drejtohet zyrtarisht me një ndalesë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin ose vendqëndrimin. Të dhënat për raste të tilla pasqyrohen manualisht në portalin unik qeveritar “e-Albania”, sipas pikës 1 të këtij neni, nga punonjësit e ngarkuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Individit ose përfaqësuesi/ja i/e familjes pajiset me një vërtetim të regjistrimit të kërkesës së tij/saj në regjistrimin e kërkesave të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe në portalin qeveritar. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson aplikimin me dokumentacionin e nevojshëm për këta aplikantë.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Dokumentacioni i nevojshëm, që i bashkëlidhet kërkesës për përfshirjen në programet sociale të strehimit, gjenerohet nga portali unik qeveritar “e-Albania” pa pagesë, me përjashtim të vërtetimeve të lëshuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për pasjen ose jo të pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to. Pagesa për tarifën e nevojshme për procesin e aplikimit për personat me aftësi të kufizuara apo dhe familjeve pa të ardhura sigurohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.”.

Neni 5

Në nenin 15 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Përveç rasteve të përmendura në pikën 1 të nenit 47/1 dhe nenit 64/2, përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/vendqëndrimit të aplikantit.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 përmban 25 pikë. Mënyra e shpërndarjes së pikëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara, miratohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili shpallet publikisht sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore.”.

3. Pika 3 shfuqizohet.

4. Në pikën 4 togfjalëshi “listat e përfituesve” zëvendësohet me togfjalëshin “listat e kërkuesve”.

5. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Lista e përfituesve hartohet nga zyra përgjegjëse ose struktura e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e kërkuesve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohen nga komisioni i strehimit dhe miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Pas marrjes së fondit takues nga buxheti i shtetit, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton listën përfundimtare të përfituesve, të cilën e shpall publikisht sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore në fuqi.”.

6. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Familjet e listës kërkuese, që nuk arrijnë të përfitojnë strehim, qëndrojnë në listë pritjeje për t'u trajtuar:

a) me një program tjetër, kur ato nuk mund të përballojnë kostot e programit për të cilin janë miratuar;

b) në vitin pasues, kur fondet janë të pamjaftueshme.”.

Neni 6

Në nenin 16 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Nënndarja “iv” e shkronjës “b” ndryshohet si më poshtë:

“iv. familje të reja”.

2. Pas nënndarjes “iv” të shkronjës “b” shtohet nënndarja “v” me këtë përmbajtje:

“v. të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.”.

3. Nënndarja “i” e shkronjës “c” ndryshohet si më poshtë:

“i. personat me aftësi të kufizuara, sipas pikës 28 të nenit 2 të këtij ligji.”.

4. Në nënndarjen “iv” të shkronjës “c” pas fjalës “azilkërkues” shtohen fjalët “refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese”, në kuptim të legjislacionit përkatës”;

5. Nënndarja “ix” e shkronjës “c” shfuqizohet.

Neni 7

Shkronja “b” e pikës 1 të nenit 18 ndryshohet si më poshtë:

“b) blerje të banesave në treg të lirë ose pas ankandit të parë të banesave që shiten sipas parashikimeve të nenit 557 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet e blerjes së banesave pas ankandit të parë, në kontratën e shitjes parashikohet marrëveshja kufizuese që ndalon tjetërsimin e pasurisë ose ndryshimin e destinacionit të saj për përdorim si banesë sociale.”.

Neni 8

Në nenin 19, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Rregullat e zbatimit të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 9

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Mbështetja e pronarit social

1. Pronari social mbështetet nëpërmjet financimeve për subvencionin e qirasë për familjet përfituese.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet buxhetit të saj ose me bashkëfinancim me buxhetin e shtetit financon për riparimin e banesës në pronësi të pronarit social, kur vlera e investimit nuk është më shumë se 30% e kostos së ndërtimit të një objekti të ri dhe jo më shumë se 1 000 000 lekë. Në rast se banesa ka nevojë për një vlerë më të madhe investimi, diferenca paguhet nga pronari social në mënyrë të menjëhershme ose me këste sipas marrëveshjes që lidhet midis tij dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kontrata noteriale e lidhur ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe pronarit social, në këtë rast, lidhet me një afat më të gjatë se 5 vjet. Në rast se kontrata prishet në mënyrë të njëanshme nga pronari social, ky i fundit detyrohet të kthejë shumën e investuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për vitet e ngelura, detyrim ky i cili parashikohet në kontratën e lidhur. Ky detyrim vendoset në kartelën e pasurisë së paluajtshme të pronarit social.”.

Neni 10

Në nenin 30 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pikat 4, 5 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

“4. Për banesat sociale me qira, që përftohen nga përshtatja e objekteve të dala jashtë funksionit, sipas përcaktimit të shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet nga këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore sipas pikës 3 të këtij neni bazuar në vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre.

5. Kur banesat sociale me qira sigurohen sipas nenit 19 të këtij ligji dhe shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji, masa e qirasë sociale përcaktohet sa 3% e llogaritur mbi koston e ndërtimit që miratohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “dh” të nenit 72 të këtij ligji.

6. Kur banesa sociale me qira sigurohet sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji, masa e qirasë sociale llogaritet sa 3% e kostos së financuar ose bashkëfinancuar.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Kur banesa sociale me qira sigurohet sipas shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet në marrëveshjen që lidhet ndërmjet subjektit që ka financuar dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zbatohet projekti. Masa e qirasë, e shprehur në lekë për metër katror, si rregull, mbulon kostot për administrim, mirëmbajtje, kosto operacionale dhe kosto të investimit ose të shlyerjes së borxhit. Nivelin e qirasë sociale nuk duhet të jetë më i lartë se 80% i nivelit mesatar të qirasë së banesave në treg, sipas pikës 36 të nenit 2 të këtij ligji.”.

Neni 11

Shkronja “d” e pikës 1 të nenit 31 ndryshohet si më poshtë:

“d) të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 20 të këtij ligji. Në këtë rast, njësia e vetëqeverisjes vendore i propozon familjes lidhjen e një kontrate sipas pikës 6/1 të nenit 30 të këtij ligji.”.

Neni 12

Në shkronjën “ë” të pikës 3 të nenit 34 pas fjalës “azilkërkuesit” shtohen fjalët “dhe refugjatëve dhe personave me mbrojtje plotësuese në kuptim të legjislacionit përkatës për refugjatët dhe personat me mbrojtje plotësuese”.

Neni 13

Në nenin 37 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Fjalja e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Subvencionin paguhet drejtpërdrejt në llogarinë të pronarit social ose për llogarinë të qiramarrësit kur parashikohet në kontratën e lidhur.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Buxheti i shtetit subvencionon përqindjen e tatimit përkatës mbi kontratën e lidhur për llogarinë të pronarit social.”.

Neni 14

Pika 4 e nenit 39 ndryshohet si më poshtë:

“4. Subvencionin i qirasë i jepet përfituesit bazuar në kontratën e qirasë të lidhur me pronarin social nga momenti që lista e përfituesve miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.”.

Neni 15

Titulli i kreut VI ndryshohet dhe zëvendësohet me:

“Programi për përshtatjen e objekteve shtetërore në banesa sociale dhe përmirësimin e kushteve të banimit”.

Neni 16

Në nenin 40 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalja me këtë përmbajtje:

“Objektet e kthyera në fond banese sipas këtij neni qëndrojnë në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe përdoren për programin e banesave sociale sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 17

Pika 1 e nenit 41 ndryshohet si më poshtë:

“1. Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve, janë:

- a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;
- b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.”.

Neni 18

Në nenin 42 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 e nenit 42 ndryshohet si më poshtë:

“1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për:

- a) përmirësimin e zonave të papërshtatshme sipas përcaktimit në pikën 52 të nenit 2 të këtij ligji;
- b) përshtatjen e objekteve shtetërore të dala jashtë funksionit, me kusht që kostoja për metër katror për realizimin e investimit për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku realizohet investimi të mos jetë më e lartë se 80% e koston së ndërtimit, të miratuar sipas shkronjës “dh” të nenit 72 të këtij ligji;
- c) përmirësimin e banesave të amortizuara dhe atyre në rrezik shembjeje, me kushtin që kostot e përmirësimit të mos jenë më të larta se 70% e koston së ndërtimit të një objekti të ri, sipas normave të strehimit.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kufijtë e financimit për çdo projekt individual dhe masa e granteve për çdo familje përcaktohen në termat e referencës, që miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për strehimin çdo vit para shpalljes së garës për grantin konkurrues.”.

Neni 19

1. Në pikën 1 të nenit 46 shtohen germat “d” e “dh” me këtë përmbajtje:

“d) familjet e punonjësve të rendit të rënë në detyrë, që përfitojnë kredi me interes 0% sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 47/1;

dh) fëmijët në përkujdesje të Republikës sipas legjislacionit në fuqi.”.

2. Në fund të pikës 2 të nenit 46 shtohen fjalët me këtë përmbajtje: “përveç rasteve të përcaktuara në shkronjat “d” e “dh” të pikës 1 të këtij neni për të cilët shumta e grantit është 20% e çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.”.

Neni 20

Pas nenit 47 shtohet neni 47/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 47/1

Kufijtë e interesave

1. Përfitojnë kredi me interes të barabartë me 0% të subvencionuar nga buxheti i shtetit nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave:

a) familjet që banojnë si qiramarrës në ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012, të Këshillit të Ministrave “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”, të miratuar me ligjin nr. 82/2012;

b) familjet e punonjësve të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë;

c) fëmijët në përkujdesje të Republikës.

2. Institucionet përgjegjëse, procedurat e miratimit dhe dokumentacioni që duhet të dorëzojnë këto familje, përcaktohen me vendim të Këshilli të Ministrave.

3. Përveç kategorive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kategoritë e tjera përfitojnë kredi me interes deri në 3%.

4. Përfitojnë kredi me kushte lehtësuese edhe individë apo familje që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe në shkronjat “a” e “c” të pikës 1 të nenit 48 të këtij ligji, të cilët për sigurimin e strehimit të tyre kërkojnë të blejnë truall në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin ose vendqëndrimin, ku zona në të cilën ndodhet trualli të jetë e pajisur me infrastrukturën e nevojshme. Shuma maksimale e kredisë që ata përfitojnë është e njëjtë me shumën e kredisë që do të përfitonin për blerjen e një banese me kosto të ulët në treg sipas këtij neni.”.

Neni 21

Në nenin 48 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët individë e familje me të ardhura vjetore neto baras ose më të ulëta se 1/6 e vlerës mesatare të banesës në treg që përfiton individit a familja, të cilat në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore:

a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vjetët e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekjeje apo sëmundjeje të rëndë) ose force madhore;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;

c) janë të zhvendosura nga banesat sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij ligji.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 këtë përmbajtje:

“2/1. Familjet, që disponojnë banesë në pronësi nën normat e strehimit dhe paraqesin kërkesë për strehim, përfitojnë kredi me interesa të subvencionuara sipas nenit 47 të këtij ligji, në masën jo më të madhe se 60% e çmimit mesatar të shitblerjes së banesës në treg, që miratohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “dh” të nenit 72 të këtij ligji.”.

Neni 22

Neni 50 riformulohet si më poshtë:

“Neni 50

Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bazë të përcaktimit të zonave të banimit, dokumenteve të planifikimit qendror e vendor, vlerësimit të nevojave për strehim social dhe kërkesave për ndërtim banesash sociale, planifikojnë sipërfaqet e nevojshme të truallit për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin.

2. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin për ndërtimin e banesave sociale përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndryshimet e bëra sipas kësaj pike pasqyrohen edhe në dokumentet e planifikimit qendror e vendor.

3. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin përfshin hartimin dhe miratimin e projektit të ndërtimit deri në përfundimin e tij. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin realizohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore apo entet publike/personat juridikë në varësi/pronësi të saj.

4. Zhvillimi i zonës, sipas pikës 3 të këtij neni, bëhet me investimet nga buxheti i shteti, buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore, financime nëpërmjet huave dhe/ose në bashkëpunim me sektorin privat sipas legjislationit në fuqi.

5. Programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimin realizohet në troje që janë pronë e shtetit/njësisë së vetëqeverisjes vendore ose private.

6. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin mund të zbatohet edhe në zonat:

a) me ndërtime të palegalizuara, që nuk mund të legalizohen;

b) me ndërtime të papërfunduara, të identifikuara si të tilla nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c) e vjetra industriale, jofunksionale, të zëna nga individë të pastrehë, pa autorizime përkatëse për strehim.

7. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimi sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 6 të këtij neni, realizohet edhe nëse në ato zona mund të gjenden ndërtime me tituj pronësie duke shpronësuar pronarët e tyre nëpërmjet shpronësimit me shkëmbim në ndërtimet e reja.

Pronari privat kompensohet me sipërfaqe ndërtimi banesë në ndërtesën (pallat) ose shtëpi individuale banimi, pasuri shtetërore ose e ardhshme. Për truallin në pronësi, pronari privat kompensohet duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin me interes publik sipas legjislacionit në fuqi ose me sipërfaqe ndërtimi banimi në ndërtesat e reja që i korrespondon vlerës së kompensimit të truallit.

Rregullat, kushtet dhe kriteret e shpronësimit me shkëmbim sipas parashikimeve të kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe deri në përfundimin e punimeve subjektet përfituese sipas këtij neni, nëse nuk kanë në pronësi ose posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga shteti apo njësia e vetëqeverisjes vendore sipas parashikimeve të këtij ligji.

9. Trualli i pajisur me infrastrukturë, pjesë e zhvillimit të një zone me qëllim strehimin, mund t'u ofrohet për ndërtim, pa shpërblim, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, edhe familjeve përfituese që marrin përsipër të ndërtojnë banesën mbi të me shpenzimet e tyre, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 23

Në nenin 51 bëhet shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) ndërtimet e përjashtuara nga legalizimi si rrjedhojë e realizimit të investimeve të veprave publike, pavarësisht zonës ku po zhvillohet projekti.”.

Neni 24

Pas kreut X shtohet kreu X/1 me titull e përmbajtje, si më poshtë:

“KREU X/1 KREDITË E LEHTËSUARA PËR BLERJEN E BANESËS PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Neni 64/1

Kushte të përgjithshme dhe të veçanta për të përfituar nga programi

1. I punësuar në administratën publike, që të përfitojë kredi të lehtësuara për strehim, duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:

a) të ketë përfunduar periudhën e provës në institucionin ku është punësuar, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhënien e tij të punësimit;

b) të plotësojë njërin nga kushtet e mëposhtme të strehimit:

i. të mos ketë banesë në pronësi në emër të tij dhe në emër të secilit prej anëtarëve të familjes;

ii. të banojë në një banesë me sipërfaqe më të vogël se ato të përcaktuara në standardet në fuqi për projektimin e banesave.

2. Kriteret e veçanta, niveli maksimal i të ardhurave që duhet të ketë familja e të punësuarit në administratën publike, si dhe normat e strehimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për strehimin.

Neni 64/2

Paraqitja e kërkesës dhe miratimi

1. I punësuar i në administratën publike, që plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 64/1, paraqet kërkesën për kredi të lehtësuar pranë institucionit ku është i punësuar.

2. Kërkesa paraqitet pranë strukturës së institucionit, e caktuar në rregulloren e brendshme të institucionit ose e ngritur posaçërisht me urdhër të titullarit të institucionit për të shqyrtuar kërkesat për kredi për strehim.

3. Titullari i institucionit të administratës publike harton listën me të punësuarit e institucionit që plotësojnë kriteret sipas nenit 64/1 dhe ia përcjell për miratim ministrit përgjegjës që mbulon institucionin ose Kryeministrisë, brenda kuotave të miratuara sipas pikës 1 të nenit 64/5 të këtij ligji.

4. Procedurat për paraqitjen e kërkesës, shqyrtimin dhe miratimin e listës së të punësuarve në administratën publike, si dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë ai, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për strehimin.

Neni 64/3

Masa e subvencionit dhe shuma e kredisë

1. Për blerjen e një banese në treg, i punësuar i në administratën publike përfiton kredi me interes deri në 3%. Diferenca ndërmjet interesit të përcaktuar sipas marrëveshjes së nënshkruar nga ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për strehimin me institucionet financiare dhe interesit që paguhet nga përfituesi, subvencionohet nga buxheti i shtetit.

2. I punësuar i në administratën publike përfiton kredi në masën e barabartë me vlerën e banesës në treg nëse me vendim të Këshillit të Ministrave është miratuar një garanci shtetërore për huan ose kur institucioni financiar parashikon financim 100% të vlerës së banesës.

3. I punësuar i në administratën publike, që banon nën normat e strehimit sipas përcaktimeve të këtij kreu, përfiton kredi të lehtësuar në masën jo më shumë se 60% e vlerës së banesës në treg që i takon sipas përbërjes së tij familjare.

4. Vlera e banesës mbi të cilën llogaritet shuma e kredisë sipas pikave 2 e 3 të këtij neni përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për strehimin, bazuar në vlerat mesatare të banesave në treg për përbërjen familjare të të punësuarit në administratën publike.

Neni 64/4

Rastet e veçanta të vazhdimit dhe ato të ndërprerjes të subvencionimit të interesave të kredisë

1. Në rast se gjatë zbatimit të kredisë, i punësuar i në administratën publike kalon në statusin invalid, i paaftë për punë dhe për të vijuar marrëdhënien e punës, kredia vijon të përfitohet me të njëjtat kushte të lehtësuara.

2. Në rast se gjatë zbatimit të kredisë i punësuar i në administratën publike humb jetën, kredia vijon të përfitohet nga anëtarët e familjes të të punësuarit në administratën publike me të njëjtat kushte të lehtësuara.

3. Kredia konvertohet drejtpërdrejt në kredi tregtare në rastet kur:

a) i punësuar i në administratën publike largohet me dorëheqje nga vendi i punës përpara afatit 5-vjeçar nga lidhja e kontratës së kredisë së lehtësuar për strehim, me përjashtim të rastit kur i punësuar i në administratën publike largohet me dorëheqje nga vendi i punës për t'u punësuar në një institucion tjetër të administratës publike dhe kur i punësuar i administratës publike arrin moshën e daljes në pension;

b) i është dhënë masë disiplinore "largim nga detyra";

c) nëpunësi civil pezullohet nga ushtrimi i detyrës me kërkesë të motivuar të tij për shkaqe të një interesi të ligjshëm, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil në fuqi.

Neni 64/5

Zbatimi i programit të kreditimit të lehtësuar

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike miratohen çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministrat përgjegjës sipas fushave të përcaktuara në kuotat prioritare përcaktojnë kuotat për institucionet e varësisë dhe ua përcjellin titullarëve të këtyre institucioneve.

2. Programi i kreditimit të lehtësuar për të punësuarit në administratën publike realizohet nga bankat e nivelit të dytë me të cilat është lidhur marrëveshja nga ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për strehimin.

3. Fondet e nevojshme planifikohen në buxhetin e shtetit në programin e strehimit, që mbulohet nga ministria përgjegjëse për strehimin.

4. Rregullat për bashkërendimin e punës së institucioneve të administratës publike me ministrinë përgjegjëse për strehimin dhe atë për financat dhe me bankat e nivelit të dytë për planifikimin e fondeve, zbatimin e programit dhe monitorimin, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për strehimin.”.

Neni 25

Neni 71 shfuqizohet.

Neni 26

Në nenin 72 bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Në shkronjën “d” fjalët “udhëzim të ministrit përgjegjës për strehimin” zëvendësohen me fjalët “vendim të Këshillit të Ministrave”.

2. Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) përcakton nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave dhe vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg në kuadër të programeve të këtij ligji, e cila propozohet nga ministria përgjegjëse për strehimin dhe miratohet brenda muajit dhjetor të çdo viti me udhëzim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) zbaton programe sipas këtij ligji nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave.”.

4. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) bazuar në strategjinë e strehimit harton plane 4-vjeçare strehimi, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 27

Në nenin 73 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “e” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“e) krijon dhe përditëson bazën e të dhënave në nivel vendor, e cila ndërvepron me bazën e të dhënave në nivel kombëtar, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “d” të nenit 72 të këtij ligji.”.

2. Shkronja “ë” e pikës 2 shfuqizohet.

3. Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 28

Pas nenit 73 shtohet neni 73/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 73/1
Monitorimi

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i paraqesin ministrisë përgjegjëse për strehimin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, një raport të detajuar sipas formatit tip të miratuar nga

ministrria përgjegjëse për strehimin, pjesë e metodologjisë së parashikuar në pikën 2 të këtij neni, për zbatimin dhe progresin për çdo program të strehimit social dhe çdo grup të pafavorizuar, përfitues sipas ligjit. Mosparaqitja e këtij informacioni përbën shkas për mospërfshirjen e njësisë së vetëqeverisjes vendore në financimin ose bashkëfinancimin e programeve të strehimit nga buxheti i shtetit për vitin pasardhës.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin monitoron zbatimin e programeve sociale të strehimit sipas këtij ligji, bazuar në raportimet periodike dhe vizita në terren, sipas metodologjisë së miratuar nga ministri përgjegjës për strehimin.

3. Rregullat për subjektet monitoruese dhe raportuese, afatet kohore të monitorimit, formatet e monitorimit dhe të raporteve monitoruese në zbatim të këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për strehimin.”.

Neni 29

Pas nenit 75 shtohen nenet 75/1 e 75/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 75/1

Kundërvajtjet dhe masat administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) shkelja e procedurave dhe afateve të përcaktuara në nenet 5, pika 3, dhe 6 të këtij ligji dhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre dënohet me gjobë në masën 300 000 lekë;

b) mospasqyrimi në portalin qeveritar të kërkesave të individëve/familjeve, që nuk kanë akses në sistem, sipas nenit 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë;

c) mospublikimi i listës paraprake dhe asaj përfundimtare të përfituesve pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas nenit 15 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 300 000 lekë;

ç) moszbatimi i pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji dënohet me gjobë sa 10% e kostos së sipërfaqes së ndërtimit të papërfutur;

d) mosparaqitja e raportit për zbatimin dhe progresin për çdo program strehimi social dhe çdo grup të pafavorizuar përfitues nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas nenit 73/1 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë.

2. Kryetari i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore është përgjegjës për shkeljet sipas shkronjave “a”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni. Nëpunësi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, i ngarkuar me detyrën e pasqyrimin në portalin qeveritar “e-Albania” të kërkesave, është përgjegjës për shkeljet sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.

3. Organi përgjegjës për shqyrtimin dhe vendimmarrjen për kundërvajtjet administrative sipas këtij neni është nëpunësi i parë autorizues i ministrisë përgjegjëse për strehimin për shkeljet sipas shkronjave “a”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij neni dhe nëpunësi i parë autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore për shkeljen sipas shkronjës “b” të këtij neni. Cilido subjekt që vëren apo vihet në dijeni të shkeljeve sipas këtij neni, i referon ato pranë strukturës përgjegjëse për strehimin pranë ministrisë që mbulon strehimin dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, vendimmarrjes dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative zhvillohen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative. Vendimet për kundërvajtjen administrative ankimohen drejtpërdrejt në gjykatën administrative kompetente në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 75/2

Ekzekutimi dhe ankimimi i vendimeve

1. Masa e dënimit, e përcaktuar me gjobë, shlyhet me këste mujore. Këstet mujore shlyhen sipas përcaktimeve të ligjit për kundërvajtjet administrative.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin ose njësia e vetëqeverisjes vendore ekzekutojnë gjobat përmes zyrës së financës. Masa e gjobës derdhet përkatësisht në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për strehimin ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.”.

Neni 30

Në pikën 1 të nenit 76 shfuqizohen referencat e neneve 71 dhe 73 të ligjit.

Neni 31

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Privatizimi i banesave apo objekteve të kthyer në fond banese bëhet bazuar në sipërfaqet e banimit, të përcaktuara për normat e strehimit, sipas certifikatës familjare në momentin kur i ka lindur e drejta e privatizimit për shkak të miratimit të një organi publik. Çdo sipërfaqe banimi e përfituar mbi atë të normave të strehimit llogaritet me koston aktuale të ndërtimit.”.

2. Shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“ç) banesat dhe objektet e kthyer në fond banese me vendime të Këshillit të Ministrave, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilat i kanë kaluar në administrim Entit Kombëtar të Banesave me qëllim privatizimin e tyre.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Familjeve të shpërngulura nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës, si edhe i familjeve të trajtuara për meremetime banesash, të cilat kanë përfituar kredi nga buxheti i shtetit nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave sipas listës emërore që disponohet nga ky i fundit, bazuar në aktet nënligjore të renditura në shtojcën 1 që i bashkëlidhet këtij ligji, u falen detyrimet monetare.”.

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Banesat e ndërtuara me fonde publike nga Enti Kombëtar i Banesave ose të transferuara nga të tretët tek Enti Kombëtar i Banesave, të cilat nuk janë pajisur me dokument pronësie, trajtohen sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe regjistrohen në emër të Entit Kombëtar të Banesave. Në rastet kur mungon dokumentacioni i kolaudimit të objekteve, ai përgatitet nga Enti Kombëtar i Banesave dhe i bashkëlidhet dokumentacionit që kërkohet nga ASHK-ja për procesin e legalizimit. Pas regjistrimit dhe pajisjes me certifikatat e pronësisë, Enti Kombëtar i Banesave kryen procedurat e privatizimit sipas aktit nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave sipas pikës 3 të nenit 77 të këtij ligji. Rregullat e posaçme për miratimin e dokumentit të pronësisë për këto pasuri përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

5. Pas pikës 7 shtohen pikat 7/1 e 7/2 me këtë përmbajtje:

“7/1. Banesat e përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, të cilat figurojnë në pronësi të shtetit, transferohen në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore për kryerjen e procedurave të privatizimit, sipas pikës 3 të këtij neni.

7/2. Të gjitha objektet, që trajtohen sipas këtij neni, përjashtohen nga detyrimi për sigurimin e objektit për raste fatkeqësie natyrore.”.

6. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikojnë që në programet sociale të strehimit jo më pak se 5 për qind e vendeve nga çdo program të plotësohen nga familje të minoriteteve rome e egjiptiane. Familjet e minoriteteve rome dhe egjiptiane konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit për të gjitha kriteret e parashikuara në ligj, si dhe për përparësitë ose pikëzimet e vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në zbatim të këtij ligji.”.

7. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje:

“9/1. Familjet pa të ardhura dhe me të ardhura shumë të ulëta sipas përcaktimeve të shkronjave “c” dhe “ç” të pikës 45 të nenit 2 të këtij ligji, që trajtohen me subvencionimin e qirasë së banesës në tregun e lirë, nënshkruajnë kontratën pa asnjë tarifë me kryetar/in/en e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose personin e autorizuar prej tij/saj, ose para punonjësit i cili nënshkruan si i pranishëm. Kontrata

regjistrohet në një rubrikë të posaçme në sistemin e strehimit të ngritur në portalin qeveritar “e-Albania” sipas neneve 72 e 73 të këtij ligji, ku pasqyrohen të dhënat për:

- a) palët kontraktuese;
- b) kohëzgjatjen e kontratës;
- c) pasurinë, si: vendndodhja, sipërfaqja, tipologjia e njësisë së banimit dhe kushtet fizike të njësisë së banimit;
- ç) masa e qirasë mujore;
- d) të ardhurat e përfituesit të subvencionimit të qirasë;
- dh) subvencionimin mujor që përfiton individi/familja.”.

Neni 32

Kudo në ligj termi “Punëtor emigrant” zëvendësohet me “Punëtor migrant”.

Neni 33

Shtohet “Shtojca 1” që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 34

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, pika 1; 19, pika 3; 47/1, pika 2; 50, pika 7; 64/1, 64/2, 64/3, 64/5, 72/d, 72/dh, 72/gj, 73/e, si dhe 77, pika 7, të ligjit nr. 22/2018.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për strehimin të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 42/3 dhe 73/1, pika 3, të ligjit nr. 22/2018.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.6.2023.

Shpallur me dekretin nr. 102, datë 10.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

SHTOJCA 1

Dekreti nr. 886, datë 12.7.1994, i Presidentit të Republikës, “Për dhënie kredie banorëve të zonave të përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”.

Udhëzimi nr. 1, datë 20.2.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e dhënies së kredive banorëve të zonave të përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë e Pukë”.

Vendimi nr. 306, datë 30.6.1994, i Këshillit të Ministrave, “Për masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë e Pukë”.

Vendimi nr. 716, datë 18.2.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e familjeve të fshatit Fajzë të rrethit Has në tokat disponibël të Kurores së Tiranës”.

Vendimi nr. 253, datë 30.4.1998, i Këshillit të Ministrave, “Për përdorim fondi për familjet e rretheve Kukës e Has të përmbytura nga hidrocentrali, si dhe për financimin e ndërtimit të apartamenteve, për familjet që do të shpërngulen nga fshati Mërtraj”.

Vendimi nr. 413, datë 27.7.2000, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet që janë përmytur nga tokat nga ujëmbledhësi i hidrocentralit të Fierzës”.

Vendimi nr. 14, datë 8.1.1996, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, “Për dhënie kredie për ndërtim banesash në Kamicë të Komunës Qendër të rrethit të Malësisë së Madhe”.

Vendimi nr. 504, datë 25.9.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e dëmeve nga përmytjet e muajit shtator të vitit 1995”.

Vendimi nr. 54, datë 30.1.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për sistemimin e dhënie kredie familjeve të fshatrave Sharrë e Murrizë të rrethit Tiranë, 37 familjeve të Bashkisë së Kukësit dhe 5 familjeve të Komunës së Bushtricës , 2 familjeve të Komunës së Belshit në rrethin e Elbasanit, 1 familjeve të Bashkisë së Ballshit, 7 familjeve të Komunës së Vreshtasit në rrethit e Korçës dhe 5 familjeve të rrethit të Librazhdit”.

Vendimi nr. 625, datë 23.10.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për shpërndarje fondesh për investime”.

Vendimi nr. 4, datë 10.01.1996, Këshillit të Ministrave, “Për dhënie kredie për ndërtim banesash”.